



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.3.2021, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ilir Beqaj, Halil Jakimi, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Eglantina Gjermeni, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Arlind Çaçani, Klajdi Qama, Kujtim Gjuzi, Ilir Pendavinji, Zef Shtjefni dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Lefter Koka, Besnik Baraj, Nimet Musaj, Tatiana Nurçe, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Halit Valteri dhe Dritan Bici.

Të ftuar:

Etjen Xhafaj - Zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
Blendi Gonxhe - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Maksim Tashi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kristi Jorgji - Këshilltar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Punëve të Brendshme

Edmond Tarkaj - Drejtor i Policisë Rrugore

Mitat Tola - Shef i Sektorit të Policisë Rrugore

Fatmir Shehu - Drejtor Juridik në Ministrinë e Punëve të Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ilir Beqaj – Kolege dhe kolegë, fillojmë mbledhjen e komisionit, datë 26 mars, ora 09:16.

Siç kemi rënë dakord, do të vazhdojmë me projektligjin për ndryshimet në Kodin Rrugor.

Atëherë, votojmë në parim projektligjin. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Gjuzi.

Miratohet në parim.

Para se të fillojmë me shqyrtimin nen për nen, Komisioni i Integritit na sugjeron të riformulojmë shënimin në fund të faqes. Ju e keni versionin e Komisionit të Integritit dhe unë nuk po e lexoj të plotë. A jeni dakord me riformulimin e Komisionit të Integritit? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Zoti Gjuzi, edhe për integrimin abstenon? Dakord.

Miratohet.

Neni 1 (ju e keni përpara tekstin), pas pikës 8 të nenit 2 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje: “Sinjalistika rrugore për rrugë, në afërsi të të cilave ka institucione arsimore, përcaktohet në aktet në zbatim”. Ka një sugjerim nga Komisioni i Ligjeve, që shprehja “aktet në zbatim” të zëvendësohet me shprehjen “legjislacionin në fuqi të fushës”. A jeni dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Besoj se në të gjitha nenet më tej, kudo ku është “aktet në zbatim”, Komisioni i Ligjeve ka sugjeruar shprehjen “legjislacionin në fuqi të fushës”. Kështu që besoj se ramë dakord me këtë gjë dhe e ndjekim në vijimësi në të gjitha nenet.

Në nenin 2 të projektligjit është e njëjta gjë. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 4, pas pikës 18 të nenit 41, shtohet pika 19 me këtë përmbajtje: “Në aktet në zbatim përcaktohet afati kohor i dritës semaforike në të gjitha pasrastet e impianteve semaforike”. Besoj se edhe këtu duhet të themi... Komisioni i Ligjeve sugjeron që ky tekst është formuluar jo qartë. Kërkon një shtjellim.

Nuk e di nëse nga Ministria e Brendshme, zoti Tola, mund të na ndihmojë.

Julian Hodaj – Ekzakt, kryetar. Besoj se zoti Tola do të japë një formulim tjetër.

Mitat Tola – Faleminderit!

Në fakt, ne, si Polici Rrugore, si Polici Shteti, kishim kërkuar në versionin fillestar që të mbeteshim vetëm te drita e verdhë, e cila, sipas të gjitha eksperiencave të vendeve të Bashkimit Europian, është një dritë e përcaktuar në sekonda sa duhet të jetë në legjislacioni primar, pra në Kod. Në diskutime me MIE-në ramë dakord që të shtrihet për të gjitha impiantet semaforike për të tria dritat, të verdhën, të kuqen dhe jeshilen. Kam idenë që duhet rregulluar vetëm shprehja “pas “rastet”, që duhet të jetë ndonjë gabim ortografik. Duhet thënë “në të gjitha rastet e impianteve semaforike”.

Ilir Beqaj – Jo “pas rastet”, por rastet”.

Mitat Tola - Mendimi im është që duhet të jetë fjala “rastet”. Në versionet e para që kemi parë ne është “në rastet e impianteve semaforike”. Kjo pastaj rregullohet me rregulloren në zbatim të Kodit Rrugor.

Ilir Beqaj – Me “impiante semaforike” çfarë keni parasysh?

Mitat Tola – Impiantet semaforike janë impiantet e semaforëve në qendrat e banuara, që rregullojnë lëvizjen e mjeteve. Janë impiantet e thjeshta dhe impiantet e integruara.

Ilir Beqaj – Dakord, e kuptova.

Kush është dakord me këtë riformulim?

Thimjo Plaku – A mund të ndërhyj një moment?

Ilir Beqaj – Patjetër.

Thimjo Plaku – Unë do të propozoja që në vend të “rasteve të impianteve semaforike”, se ajo është e kuptueshme kur flitet për afatin kohor të dritës semaforike, të thuhet “në të gjitha ciklet e impianteve semaforike”. Mbase do të ishte më e përshtatshme.

Ilir Beqaj - Çfarë keni parasysh me “cikle”?

Thimjo Plaku – Cikli i zgjatjes së dritës së verdhë, të kuqe apo të gjelbër.

Ilir Beqaj – E themi që përcaktohet afati kohor i dritës, që është cikli, që thatë ju.

Zoti Tashi?

Maksim Tashi – Te afati kohor i dritës semaforike vihet pikë, kurse pjesa tjetër është e tepërt.

Ilir Beqaj - Zoti Tola?

Mitat Tola - Po, afati kohor i dritës semaforike është i përcaktuar.

Maksim Tashi – Vendosim pikë atje dhe mbaron fjalia.

Ilir Beqaj – Atëherë themi kështu: “afatet kohore të dritës semaforike përcaktohen në legjislacionin e fushës në zbatim”. Ky është thelbi?

Kush është dakord me këtë formulim? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni. Kundër nuk ka.
Miratohet.

Neni 5.

Kush është dakord? Abstenim. Gjuzi dhe Shtjefni. Kundër nuk ka.
Miratohet.

Neni 6.

Kush është dakord? Abstenim. Gjuzi dhe Shtjefni. Kundër nuk ka.
Miratohet.

Neni 7.

Kush është dakord? Abstenim. Gjuzi dhe Shtjefni. Kundër nuk ka.
Miratohet.

Neni 8.

Komisioni i Ligjeve ka këtë sugjerim: “Pika 1 të riformulohet duke u hartuar fjalitë në formën pohore, urdhëruese”.

Eglantina Gjermani – Nga pohore të bëhet urdhëruese.

Ilir Beqaj – E kuptoj. Ideja është që nëse ne themi në version që prodhuesit dhe përfaqësuesit “t’i transmetojnë”, ta bëjmë “i transmetojnë”. Në formë urdhërore. Ky është thelbi i sugjerimit. Jemi dakord?

Kurse Shoqata e Siguruesve propozon që pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Përpara kryerjes së çdo procedure të pagesës së taksave periodike të njësisë të kolaudimit periodik të mjetit në çdo institucion apo janë të ngarkuar të verifikohet pajisja **me një polic** të vlefshëm sigurimi për mjetin motorik”. Çfarë opinioni kanë përfaqësuesit e ministrisë?

Zoti Tashi, urdhëroni!

Maksim Tashi- Neni 79 flet vetëm për procedurat e kontrollit teknik, të cilat janë në përputhje të plotë me direktivën e Komitetit Europian dhe me Rregulloren e zbatimit të direktivës së Komitetit Europian. Këtu flitet për procedurën e kontrollit, ndërsa kjo që kërkon shoqata mund të jetë në dokumentacionin që paraqet mjeti gjatë kontrollit teknik, por nuk është pjesë e këtij neni.

Ilir Beqaj- Ju thonë që nuk mund të jetë këtu, por në cilin nen mendoni se mund të jetë?

Maksim Tashi – Ajo mund të jetë në një marrëveshje, të cilën mund t’jua thotë zoti Gonxhe.

Blendi Gonxhe –Së pari, kjo është e zgjidhur në udhëzimin e ministrit përkatës të linjës dhe është e qartësuar dhe e zgjidhur për zbatim. Gjithashtu, kjo është bërë pjesë e ligjit të posaçëm për sigurimet e detyruara, që është miratuar nga ju dhe është gati për dekretim. Kjo është parashikuar në atë ligj dhe nuk ka vend këtu.

Ilir Beqaj- Domethënë, është e tepërt këtu?!

Blendi Gonxhe- Është e tepërt këtu dhe nuk ka lidhje.

Ilir Beqaj- E kuptova.

Atëherë, neni 79, me pikën 1, me sugjerimin për redaktimin “t’i transmetojnë” të bëhet “i transmetojnë”, kush është dakord? Abstenim zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9, i cili prek nenin 92, për të cilin Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Integritetit kanë propozuar që pikat 6/1 dhe 6/2 të hiqen. I lutem propozuesit, përfaqësuesit të ministrisë, të më thotë pse i keni vendosur në propozim këto dy pika, të cilat Komisioni i Ligjeve i vlerëson si të panevojshme?

Zoti Plaku.

Mitat Plaku- Ne jemi informuar së fundmi për futjen e tyre në ligj dhe nuk kemi qenë ne propozuesit e kësaj, por, me sa kuptoj, propozuese ka qenë shoqata e sigurve. Ne mendojmë që këto të hiqen, sepse procesi është i mbuluar në procedurat që përcaktohen edhe në Kodin Rrugor për rastin e siguracioneve të gjitha penaltet janë të përcaktuara. Kështu që mendojmë se janë të panevojshme.

Ilir Beqaj – Drejtoria e Policisë a ka ndonjë opinion?

Zoti Tola?

Mitat Tola – Faleminderit!

Po t’i shikosh statistikat e aksidenteve rrugore që nga viti 2013 dhe deri më sot, raporti i mjeteve, pra statistikat që i mban Policia Rrugore për çdo aksident, pasojë me njerëz dhe dëme materiale ka diçka që nuk shkon dhe doja ta shprehja këtë shqetësim. Në vitin 2013 nga 1780 mjete të përfshira, 270 mjete kanë rezultuar të pasiguruara’ e njëjta tablo ose e njëjta përqindje është edhe në vitin e fundit. Domethënë, në aksidentet rrugore me pasojë, të cilat janë aksidente të kushtueshme nga pikëpamja financiare, ka 10% deri në 14% mjete të përfshira që janë të pasiguruara, pa i ndara këto nga karroca, nga çiklomotori, nga biçikleta e deri te mjetet e rënda. Pra, shqetësimi i Policisë Rrugore lidhet edhe me një handikap që ndodh në nenin përkatës, i cili në vitin 2011 e ka hequr ndalimin administrativ të mjetit, kur mjete konstatohet pa policë sigurimi. Për shembull, Tola konstatohet nga punonjësi i policisë

pa policë sigurimi, polici i jep një procesverbal dhe i thotë brenda 10 ditëve do të paraqitesh në organin administrativ dhe e lejon mjetin të pasiguar të lëvizë, qoftë edhe ky 10-ditësh që mjeti ose drejtuesi i mjetit sa shkon dhe pajiset me policë, është një mjet shumë i rrezikshëm, sepse mund të shkaktojë një dëm 200 milionë. Në fakt, ne si Drejtori e Policisë Rrugore duam të propozojmë që në nenin 191 të shtohet: “Ndalimi i menjëhershëm administrativ i mjetit deri në pajisjen me policë sigurimi” dhe besoj se kështu zgjidhet shqetësimi i kompanive të sigurimit.

Kujtim Gjuzi – Me leje, zoti kryetar?!

Ilir Beqaj – 1 sekondë, zoti Gjuzi.

Në fakt, edhe unë e kam parë atë aty, mund të jetë diçka që e zgjidh ose rregullon këtë shqetësim, por këtu duket pak e sforcuar.

Urdhëroni, Zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, i nderuar drejtor, zoti Tola!

I nderuar drejtor, ju e dini shumë mirë se në Europën Perëndimore çdo mjet, që kapet pa policë sigurimi, ka një afat prej 15 ditësh për të marrë siguracionin. Mendoj se brenda këtij afati mendoj, ashtu siç e ka parashikuar edhe projektligji, patjetër që masa administrative duhet të jetë 10 ditë. Pra, ne e kemi shkurtuar, nga 15 ditë që e ka Italia të paktën. Mua më ka ndodhur vetë, kur kam blerë një mjet atje, që do të vija në drejtim të Tiranës. Pra, duhet parë me pak hapësirë kjo pjesa. Unë jam shumë dakord me ju, ashtu siç e kam shprehur në ditët më parë që kam konsideratën më të lartë për ju si personalitet i policisë i Qarkullimit Rrugor në Republikën e Shqipërisë. Por në këtë rast dua t’ju lutem, që të mos jemi pedantë dhe ushtarakë të Republikës së Shqipërisë, por ta shikojmë më gjerë dhe më tutje.

Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti drejtor për mirëkuptimin, nëse e keni!

Mitat Tola – Zoti kryetar, të lutem, a mund të bëj edhe një sqarim të vogël? Në vitin 2011, kur është propozuar heqja e masës administrative për ndalimin e mjetit, numri më i madh i mjeteve të ndaluara kanë qenë çiklomotorët. Çiklomotorët në vitin 2011 nuk kanë pasur deri në 49 kubikë një target, një pllakë njohëse. Situata e pikave të bllokimit të Policisë Rrugore pësoi një kolaps nga bllokimi i mjeteve të pasiguar të tipit çiklomotor. Ndoshta u hoq kjo masë, por sot që jemi në këto kushte, në këto raporte kur një dëm shëndetësor u kushton kompanive të sigurimi jashtëzakonisht, shqetësimi i tyre është i drejtë, u kushton kompanive të sigurimi jashtëzakonisht. Shqetësimi i tyre është i drejtë. Vendosija e ndalimit

administrativ e kombinuar me masën nga 10-40 mijë lekë besoj do të ishte një farë zgjidhjeje dhe mund ta tejkalonte edhe propozimin e nenit 9.

Ilir Beqaj – Atëherë, duhet të kemi kujdes kur të vijë radha e nenit 191. E di që nuk është pjesë e projektit, por, kur t'i marrim me radhë ne si komision, mund të diskutojmë aty.

Po, zoti Bitri.

Ju lutem, audion se nuk dëgjoheni!

Robert Bitri – Komisioni i Ligjeve me çfarë argumentesh shprehet se këto duhet të hiqen? Po të dëgjojmë edhe zotin Tola, fakti që të gjithë ne, unë personalisht kam qenë 2 herë me mjete të tilla që kanë bërë karambol dhe më është dashur një sorollatje kaq e madhe që të merrja lekët e mia nga figuracioni, nëse ne do t'i mbështesim këta njerëz, të cilët nuk kanë arsye që i justifikon, nuk kanë ekonomi. Por në momentin që zoti Gjuzi dha propozimin dhe mendohet të zgjidhet me detyrimin e përkohshëm, pra heqjen e përkohshme të siguracionit, atëherë, kur ai e mban atë qoftë rregullon automjetin apo e mban në shtëpi pa qarkulluar, jam shumë dakord, por në momentin kur ata dalin pa këtë dokument gjoba duhet të jetë shumë e madhe dhe nuk ka pse ne t'i dalim në krah kujtdo që shkel ligjin. Kur shkel ligjin, ne nuk kemi pse t'i dalim në mbrojtje këtij personi. Çdo njeri para se të lëvizë me makinë duhet të ketë në rregull dokumentacionin. Shoqëria e sigurimit, ai agjenti me njofton 10 ditë përpara: “Po të afrohet problemi i siguracionit”. Unë shkoj dhe paraqitem. Nëse u lihet shoqërive të sigurimit të bëjnë këtë njoftim, atëherë mund të them se jam shumë dakord që të gjitha gjordat që do t'u vihen njerëzve, të cilët shkelin ligjin, le të jenë sa më të ashpra.

Ilir Beqaj – Në fakt, vetë formulimi që është në projekt, neni 6/1: “Cilido që qarkullon me një mjet për të cilin ka kaluar mbi 30 ditë afatin e sigurimit të detyrueshëm ndëshkohet me masë administrative me gjobë sipas gjykimit të nenit 191, pika 2”...

Po lexoj nenin 191, se ndoshta nuk e keni parasysh: “Mjetet me motor që nuk lëvizin mbi shina, duke përfshirë trolejbusët dhe rimorkiot, nuk mund të qarkullojnë në rrugë dhe vende publike pa qenë të siguruar sipas normave të dispozitave në fuqi për përgjegjësinë civile ndaj të tretëve”.

“Cilido që qarkullon pa qenë i siguruar, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga 10 mijë deri në 40 mijë lekë”.

Ndërsa këtu themi: “Cilido që qarkullon me një mjet, për të cilin ka kaluar mbi 30 ditë afati ndëshkohet me gjobë”. Pra, neni 191 thotë: “Ndëshkohet me gjobë”. Këtu thotë: “Pas 30 ditësh”. Këtu ka një plotësim më të mirë që të thotë: “Rregullat dhe procedurat për vendosjen e gjobave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Praktikisht, cilido që

qarkullon me një mjet për të cilin ka kaluar tri ditë afati i sigurimit të detyrueshëm, që qarkullon pa qenë i siguruar. Këtu janë shkruar fjalët “sigurim i detyrueshëm”.

A dëshironte të fliste ndokush?

Illir Beqaj – Zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Bitri, le të marrim një rast hipotetik: kemi një emergjencë familjare brenda shtëpisë sonë, dhe mjeti është rezidencial, pa siguracion, ka kaluar vetëm një ditë, dy ditë apo deri në dhjetë ditë. Ndërkohë, kemi një emergjencë familjare.

Ju lutem, si do ta zgjidhni ju, në kushtet kur nuk është e mundur që mjetet e shërbimit të emergjencës të jenë pranë familjes sonë? Si do ta zgjidhni ju? Pyetja është për ju, zoti Bitri.

Robert Bitri – Me taksi.

Kujtim Gjuzi – Po, po, i nderuar zoti Bitri, se ju e keni rrogën 2 milionë e 200 mijë lekë, ndërsa shqiptarët e kanë akoma 300 mijë lekë, me këto që ka rritur qeveria.

Robert Bitri – Edhe një herë, ai që e ka 300 mijë lekë, nuk ka makinë, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Tani, të lutem, parku i makinave...

Na fal, zoti kryetar, që po bëjmë një debat me kolegun.

Parku i makinave në Shqipëri, e ritheksoj, është në masën deri në 700 mijë makina, që i bie se çdo familje ka makinë brenda, por jo çdo familje...

Më dëgjo me vëmendje, të lutem!

Jo çdo familje e ka mundësinë që ta kryejë siguracionin pikërisht në ato dhjetë ditë apo në ato tridhjetë ditë. Në këtë rast, dhe po ta them fare pa hezitim: ka ndodhur që edhe brenda familjes sime të ketë qenë mjeti aty, por s’ka lëvizur për arsye siguracioni.

Në këtë rast do të më vendosni gjobën. Në rregull, se unë e përballuakam gjobën e lartë dhe lejen e drejtimit, por duhet të jemi më të kujdesshëm, sepse Europa e ka të zgjidhur këtë. Italia e ka 15 ditë. Ne, dakord, le ta afrojmë dhe ta bëjmë dhjetë ditë, ose dhe pesë ditë. Por jo merr menjëherë mjetin dhe e çon te Policia e Shtetit. Nuk dua të akuzoj askënd këtu, po kur bëhen ato KÇK-të atje, në lidhje me mjetet që janë aty, e dimë se si dalin dhe se si jepen edhe nga prokurorë të veçantë, të cilët kanë kaluar në veting. Nuk desha të kaloja te politika makro, por desha të sugjeroja që të jemi të kujdesshëm. Prandaj ju drejtova të nderuarit drejtor, zotit Tola, në lidhje me këtë këshillim. Ju keni maxhorancën dhe mund ta bëni si të doni.

Nëse e keni vënë re, gjatë gjithë këshillimit në lidhje me projektligjin, ne kemi abstenuar. Ne dimë të japim edhe votën kundër në këtë rast, pavarësisht se ju keni

maxhorancën, por kjo do të kishte kosto tjetër pastaj. Nuk mendoj se duhet të nxitojmë në lidhje me këtë. Nëse duam të shkojmë në Europë, nuk duhet ta përafrojmë, por mundësisht ta marrim edhe motamo legjislacionin europian.

Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Bitri!

Ilir Beqaj – Zoti Tashi!

Zërin, të lutem.

Maksim Tashi – Për t’ju sqaruar?

Ilir Beqaj – Po.

Maksim Tashi – Pika 6/ 1 dhe pika 6/ 2 nuk janë për mjetet që qarkullojnë dhe i kap policia pa siguracion. Në lidhje me këtë zbatohet neni 191/2, që vendos gjobën 10 mijë deri në 40 mijë lekë.

Këto dy pika, të cilat janë shtuar nga shoqëritë e sigurimit, janë shtuar për mjetet që nuk bëjnë siguracion në kohë, e që nuk janë në shtëpi. Kjo do të thotë se, pasi kalon tridhjetëditëshi, qendra e informacionit njofton policinë dhe DPSHTRR-në për të vendosur e për të ekzekutuar gjobën.

Për mendimin tim kjo nuk është normale, sepse me të njëjtën logjikë, ne kemi edhe taksat vjetore të mjeteve, dhe taksat vjetore të mjeteve bëhen një herë në vit, por në raste të veçanta, kur në funksion të ngarkesës që ka, siç ishte rasti i zotit Gjuzi, bëhet edhe çregjistrimi i përkohshëm i mjetit, duke dorëzuar lejen e qarkullimit dhe targat. Në këtë moment, subjekti ose pronari i mjetit nuk paguan asnjë lloj detyrimi të shteti përkundrejt taksave të përvitshme. Në analogji, kjo do të jetë edhe për siguracionin. Në momentin që ai bën çregjistrim të përkohshëm, që janë rreth 25 mijë mjete në vit, që bëjnë çregjistrim të përkohshëm për arsye nga më të ndryshmet, edhe mjetet e mallrave, edhe të transportit, edhe personalet, kur nuk lëvizin, siç tha zoti Gjuzi, që mund të ketë raste kur shkon në një shërbim jashtë shteti afatgjatë e të tjera me radhë, dorëzon targat dhe lejen e qarkullimit, bëhet çregjistrimi i përkohshëm dhe në këtë moment, qendra e informacionit do të njoftojë edhe policinë, edhe DPSHTRR-në që ky mjet nuk ka paguar siguracionin, i prishet gjoba dhe krijohet një lëmsh shumë i madh. 25 mijë mjete në vit që bëjnë çregjistrime të përkohshme, i bie afërsisht rreth 100 mjete në ditë dhe do të ketë korrespondenca pa fund ndërmjet policisë, DPSHTRR-së dhe Qendrës së Informacionit, flas për këto lloj mjetesh. Ndërsa, çdo lloj mjeti që kapet nga policia, siç tha zoti Bitri, në rrugë, pa siguracion, le dhe të përdoret çdo lloj mase administrative dhe plotësuese, që thotë zoti Tola.

Thimjo Plaku – Maks, më duhet të të ndërpres, të lutem! Në qoftë se e lexoni dispozitën, ka një zhvendosje nga propozuesit. Nuk është më versioni i parë. Bëhet fjalë për cilindo që qarkullon me një mjet, jo që është në shtëpi, pra “që qarkullon”. Pra, e kanë zbutur qëndrimin. Kështu, midis atij që kapet dhe ka 5 ditë që i kaluar afati dhe atij që i ka kaluar 30 ditë, ka ndryshim. Për rastin e parë është neni 191, ndërsa për rastin e dytë, që i ka kaluar afati 30 ditë kërkohet të shtohet një bonus në gjobë që do të përcaktohet me VKM, ndofta duke u barazuar me Italinë.

Maksim Tashi – Jo. Nuk ka bonuse në Këshill të Ministrave. Bonusit i ka ligji dhe ligji nuk ka asgjë.

Thimjo Plaku – Nuk bëhet fjalë më për gjoba automatike në versionin që është në tavolinë. Ka rënë versioni i gjobës. Bëhet fjalë vetëm për mjete që kapen në rrugë pas një muaji. Lexoje dispozitën!

Ilir Beqaj - Këtu thuhet “cilindo që qarkullon”, pra qarkullon dhe nuk e ka në shtëpi. Kjo është çështja e parë.

Thimjo Plaku – Atëherë kemi 191/2.

Ilir Beqaj – Ju thoni se nuk duhet kjo se e zgjidh 191/2-shi?

Maksim Tashi – Në qoftë se do ta lëmë te vendimi i qeverisë, siç thotë zoti Tola...

Ilir Beqaj – Jo, nuk e vendos VKM-ja gjobën, gjobat i vendos vetëm ligji. Nuk ka gjoba me VKM. Në qoftë se duam të vendosin gjobë, duhet ta vendosim këtu.

Maksim Tashi – Atëherë, vazhdimi i fjalisë këtë ka, që t'i kalojmë topin më poshtë dhe të vendosim në mënyrë...

Ilir Beqaj – Jo, jo. Rregullat dhe procedurat, por jo masën e gjobës. Nuk ka në Shqipëri masë gjobe me VKM. Të jemi të qartë për këtë gjë.

Maksim Tashi – Po nuk ka gjobë fare këtu.

Ilir Beqaj – Është gjoba e 191-shit. Ajo është gjoba.

Maksim Tashi – Po atëherë, si me 30 ditë, si pa 30 ditë...

Ilir Beqaj – Kjo është pyetja ime. Te 191-shi e lëmë që ditën e parë, këtu ia lëmë pas 30 ditësh. Kjo është diçka që duhet rakorduar. Ndërkohë, te 6/2-shi...

Maksim Tashi – 6/2-shi thotë se Qendra e Informimit njofton menjëherë...

Ilir Beqaj – Dakord, le të njoftojë, kjo është punë tjetër.

Maksim Tashi - Më pas thuhet, për ekzekutimin e masës administrative...

Ilir Beqaj – Por jo për vendosje, por për ekzekutim.

Maksim Tashi – Po pra, gjoba këtu do të vendoset në mënyrë elektronike nga qendra e informacionit. Do të shihet në kompjuter nëse ka kaluar afati dhe më pas vendoset gjoba, sipas 191, duke i shkuar gjoba në shtëpi individit.

Ilir Beqaj – Një sekondë, nuk mund të vendoset gjobë nga kompjuteri nëse ai nuk qarkullon, se kështu thuhet në pikën 6/1.

Maksim Tashi – Atëherë, po qendra çfarë do të informojë?

Ilir Beqaj – Thjesht do të informoj atë gjë...

Për mua 6/2 është i panevojshëm, sepse e kemi zgjidhur te ligji përkatës, prandaj e kemi krijuar qendrën që të komunikojë si të dojë me institucionet.

Zoti Gonxhe, fjala për ju.

Blendi Gonxhe – Zoti kryetar, më ndjeni, por është diçka që nuk e gjej normale, pasi në Komisionin e Ligjeve u bë një bisedë shumë e qartë dhe e plotë, madje u kërkua edhe llogari se kush e ka propozuar këtë.

Ilir Beqaj – Raporti i Komisionit të Ligjeve ende nuk na ka ardhur, jemi në pritje, sepse është për t'u zbardhur. Ne nuk e kemi ndjekur diskutimin që është bërë atje.

Blendi Gonxhe – Ne sot e morëm vesh, sepse sot doli koka e kësaj gjëse, se nga ka ardhur kjo. Në fakt, këto janë bishta të mbetura nga dëshira dhe propozimi i kahershëm i Shoqatës së Siguruesve për t'i rënë shkurt. Shoqata e Siguruesve ka propozuar një paketë, por kanë harruar dy bishta, sepse u hoq pjesa tjetër e gjobës automatike dhe kanë mbetur dy pjesë, të cilat janë të tepërta, duke na ngatërruar dhe krijuar ekuivoqe te publiku dhe tek të gjithë.

Ne nuk kemi fare nevojë për këtë gjë, sepse rregullat dhe procedurat për vendosjen e gjobës për mungesën e rripit kanë ekzistuar, pra nuk është e nevojshme të përsëriten normat juridike ku parimi është i njëjtë. Procedurat dhe rregullat për vendosjen e gjobës i gjejmë të detajuara në nenin 192 të Kodit Rrugor, mbi 10 nene; neni 349 dhe vijues i VKM-së nr. 153, që është rregullorja dhe bazamenti i zbatimit të Kodit Rrugor, 11 nene të vitit 2000; nenet 10, 13 dhe vijues të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, posaçërisht për të gjitha kundërvajtjet.

Neni 10 shprehet qartë se organi administrativ kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes, përveç parimeve të parashikuara nga neni 18 i këtij ligji miraton edhe metodikën apo parime të tjera shtesë mbi të cilat mbështetet për përcaktimin e vlerës së gjobës.

Pra, mund ta zgjidhim edhe në nivel institucioni pa qenë fare nevoja këtu as për VKM dhe për asnjë gjë tjetër.

Neni 18 jep kritere për përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit. Të gjitha janë të zgjidhura në nenin 191, i cili nuk ka ndryshuar që në krijimin e Kodit, nuk është e vërtetë që ka ndryshuar ndonjëherë, nuk është hequr asgjë, është aty i plotë dhe i saktë.

Neni 203 e plotëson, që nëse nuk e paguajnë gjobën, që është vendosur, brenda afatit, kalon në kamatë, po kalove edhe një fazë tjetër të bllokohet mjeti, pra është krejtësisht e plotë.

Ndërkohë që neni 191, siç ju e cituat është shumë i qartë. Kodi është komplet i bazuar mbi konceptin italian dhe Kodi Rrugor italian është ndër më të mirët e Bashkimit European. Sot, nuk ka asnjë vend të Bashkimit European që të lërë aludime për gjoba automatike, është një gënjeshtër ajo që thonë se ka në Bullgari dhe në Kosovë, sepse nuk ka askund. Luhet me bonuset e Bonus-Malus-it, luhet me humbjet, luhet me incentivat, luhet me nxitjen e rinovimit të siguracionit, duke ulur çmimet, sepse janë vende që kanë politika krejt të ndryshme dhe ku kartoni jeshil është 60 euro, ndërsa te ne është 400 euro.

Vetëm nga TPL-ja, më duhet t'ju them këtë, vetëm në vitin 2020 janë paguar 22 milionë euro dëme, janë grumbulluar 74 milionë euro, vetëm nga TPL-ja nga siguratorët, si dhe pretendojnë që kanë një debi 40 milionë euro për rastet e pazgjidhura, të cilat përbëjnë 15% të aksidenteve, por as kjo nuk është e vërtetë. Ka shumë raste që policia nuk e di, sepse shumë persona që largohen nga vendi i ngjarjes, pasi ata largohen nga shkaku i alkoolit dhe i frikës se mos dënohen, por kjo nuk dëmton se është i pasiguruar. Nga ana tjetër, edhe nëse është i pasiguruar, ose pa targa, ose pa taksa, është njësoj për të gjithë ne, është një mjet që është në rrugë në mënyrë të paligjshme dhe nuk është se figuron se do të rinovojë dhe sigurocionin që ta kapni ju dhe ta dënonim. Ky është pa targa, me targa të tjera, nuk ka paguar taksat, është pa kolaudim dhe është në rrugë. Ky është subjekt i kapjes telematike, vizuale ose fizike nga policia në rrugë dhe kjo është detyrë e Policisë së Shtetit. Nëse nuk e bëjnë mirë këtë detyrë tani, do ta bëjnë më mirë në vitet që vijnë, sepse do të modernizohemi, do të rrisim logjistikën, po vëmë kamera, po vëmë sisteme, në mënyrë që ne ta kapim atë në rrugë dhe në parkime.

Pra, nuk është vetëm në rrugë në, por edhe kodi italian edhe kodi ynë është krejt i qartë: në hapësira publike dhe në qarkullim. Pra, kjo do të thotë edhe po të jesh te “Rogneri” ose në parkimin e bashkisë te sheshi “Skënderbej”, edhe po të jesh në çdolloj vendi bashkiak, komunal, parkim rrugor dhe e ke lënë makinën para dyqanit, e ke në rrugë dhe thua unë nuk qarkulloj, jo je në vend publik. I vetmi vend ku ti nuk paralizohesh, sipas kodit tonë, ose kodit italian dhe kodeve të vendeve të BE-së, është kur ti e ke në parkingun tënd personal në shtëpi. Në rast se ti je në parkingun tënd personal, në garazhin tënd pa siguracion, ti nuk je

në qarkullim dhe nuk të ngacmon askush. Shoqata do që ne t'u vëmë gjoba qytetarëve edhe nëse janë në spital, edhe në burg, në parkimet e tyre, apo në raste se kanë një hall apo një pamundësi për të bërë rinovim, por nuk janë në qarkullim dhe janë në parkimin e tyre privat. Pra, kjo lë këtë ekuivok.

Jua sqarova që ta dini që kjo gjë del si lobim dhe nuk tentojnë ta zgjidhin këtë punë ashtu siç duhet të zgjidhet, që ishte te ligji i posaçëm që ata e bënë . I kishim të gjitha mundësitë për ta bërë atje. Nuk pranojnë ta bëjnë bonus malosin të detyrueshëm, e bëjnë fakultativ, nuk vëmë bonuse, nuk nxisim.

Ilir Beqaj - Mos dilni nga thelbi i Kodit Rrugor, ju lutem!

Blendi Gonxhe - Kodi Rrugor është shumë i qartë. Ne jemi krejtësisht të mbrojtur dhe këto dy pika lënë vetëm ekuivokë dhe shtojmë burokraci, mbase edhe në mendje, por janë burokraci.

Ilir Beqaj – Po, zoti Hodaj.

Juljan Hodaj – Faleminderit!

Nuk dua të ripërsëris atë që tha zoti Gonxhe, por në një pikë zoti Gonxhe ka të drejtë. Në versionin e parë mund edhe të kishte sens, pra që të shërbente si një mjet, pavarësisht se nuk është detyrë e policisë të bëhet mbledhëse e gjobave dhe t'i shërbejë edhe në këtë mënyrë sektorit privat, po themi. Pra, në versionin parë mund të kishte sens, kur kalonin 30 ditë njoftohesh dhe ekzekutohej, në versionin aktual kur themi “cilido që qarkullon”, është komplet e tepërt, sepse na e mbulon shumë mirë neni tjetër. Ky është edhe qëndrimi i ministrisë.

Ilir Beqaj – Zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Dua të falënderoj zotin Gonxhe, i cili është mjaft i qartë dhe unë gjej mirëkuptim edhe në lidhje me takimin e dy ditëve më parë për këtë projektligj. Edhe një herë tjetër, këmbëngul që zoti Gonxhe tashmë është kthyer në një ekspert të kësaj fushe dhe mendoj se mendimi i tij ishte ekselent. Nuk na duhet këtu që dikush që ka fituar me 200% prej sigurisë dhe siguracioneve të vejë në poshtërim pjesën tjetër, e cila nuk ka para, por ka dinjitet. Prandaj, ne nuk mund të rrimë në një vend, siç është komisioni ynë, i nderuar, zoti kryetar, dhe të gjykojmë se sa duhet të fitojnë me 300% kompanitë.

Kështu teknikisht, edhe si ekonomist po ta them, me llogaritë paraprake, i bie që kompanitë të fitojnë 300% në vit. Nuk duhet ta lejojmë këtë. Në fakt, të gjithë marzhin e fitimit kompania duhet ta ketë maksimalisht 33%, se pjesa tjetër janë taksa që i merr shteti dhe 33% janë gjendja e stokut, për ne që kemi studiuar ekonomi. Për ata që kanë studiuar në

fusha të tjera, nuk kanë eksperiencat e duhura dhe kërkojnë të mbivendosen për ta realizuar atë program, që unë shoh se e dëmton edhe qeverinë (do të doja të dëmtohet qeveria tani para zgjedhjeve), nuk mund ta lejoj në konceptin qytetar këtë metodologji.

Pra, zoti Gonxhe, e shprehu shumë qartë se si mjeti mund të kapet në lëvizshmëri. Unë do të isha edhe për pikën tjetër, siç e ka Europa (mua më ka zënë policia në Romë-Bari, më kishte mbaruar siguracioni dhe më thanë se kisha 10 ditë afat që ta paguaja këtë siguracion), pra një shteti që iu referuan kolegët, që është i pari për qarkullimin dhe ligjshmërinë në lidhje me transportin dhe sigurinë apo Kodin Rrugor që po diskutojmë tani.

Ju faleminderit, kolegë!

Kërkoj ndjesë nëse krijova bezdi!

Ilir Beqaj – Komisioni i Ligjeve thotë se nenet 6/1 dhe 6/2 bien ndesh me dispozita të Kushtetutës.

Neni 6/3 bëhet 6/1.

Neni 9, pika 5 dhe 8 shfuqizohen. Kush është dakord me pikën 1 të nenit 9? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Pika 2. Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1, 6/2 dhe 6/3. Propozimi është që 6/1 dhe 6/2 të hiqen dhe 6/3 të bëhet 6/1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 10. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 11. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 12. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 13. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 14. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 15. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 16. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 17. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Gjuzi abstenim.

Miratohet.

Neni 18.

Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 19.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20.

Ka ardhur një sugjerim nga Komisioni i Integritit, ku thuhet: “Konfiskimi i mjetit dhe shpronësimi i personave, të cilët bëjnë shkelje në rastet e parashikuara në Kod, bie ndesh me nenin 41 të Kushtetutës”.

A ka sugjerim për nenin 20 nga Komisioni i Ligjeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa kohë që nuk ka bërë komente Komisioni i Ligjeve, i cili është më afër me çështjet ligjore dhe Kushtetutën, propozoj ta hedhim në votim nenin 20, sipas projektit të qeverisë.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 20/1.

Ka vetëm një sugjerim redaktimi, që të bëhet 20/1, me përmbajtjen përkatëse.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 21.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 22.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 23.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 25.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 26.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 27.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 28.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 29.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 30.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 31.

Në riformulim duhet vendosur edhe titulli.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 32.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Kujtim Gjuzi.

Miratohet.

Neni 33.

Kush është dakord?

Dakord. abstenim? 1 votë e zotit Gjuzi.

Miratohet.

Neni 34. Këtu ka një sugjerim nga Komisioni i Ligjeve.

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, është edhe zoti Shtjefni në linjë.

Ilir Beqaj – Po, abstenon.

Pra, ka një sugjerim. Në projektligj thuhet: “Këshillimi duhet të administrohet në sistemet e policisë”, ndërsa në propozimin e Komisionit të Ligjeve thuhet: “Duhet të

administrohet dhe të evidentohet...”. Pra, jo vetëm të administrohet, por të dokumentohet. Kush është dakord me këtë nen dhe me sugjerimin e Komisionit të Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 35. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 36. Te ky nen na mungon titulli. A do ta lëmë titullin siç është? Propozuesit dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës, do ta lëmë siç është titullin?

Maksim Tashi – Po.

Ilir Beqaj – Dakord. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 37. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 38. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 39. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 40. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 41. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 42. Afati për të nxjerrë aktet nënligjore është lënë 6 muaj. Pyes propozuesit, a i kapni këto afate?

Maksim Tashi – Patjetër.

Ilir Beqaj – Dakord. Kush është dakord me nenin 42? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 43. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota nga Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet projektligji për ndryshime në Kodin Rrugor.

Faleminderit! Ditë të mbarë! Takohemi në seancë të hënën!

MBYLLET MBLEDHJA